



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 31.01.2023, merr këtë

V E N D I M

1. **Miratohet** Plani i veprimit tre (3) vjeçar për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2025.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, Plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2025, është i bazuar në Strategjinë kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022- 2026.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi, është Plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2025.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtoritë e tjera relevante.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-550/01-24196/23, më 01.02.2023

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

Faqe 1 nga 1